Njoftim për përqendrim me të cilin N7 DEFENCE HOLDING ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG, Budapest, Hungari, do të fitojë kontrollin mbi COLT CZ HUNGARY ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG, Kiskunfélegyháza, Hungari

(lënda nr. 08-159/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 12.11.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin **N7 DEFENCE HOLDING ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG (N7 Defence Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság)**, shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rr. Asztalos Sándor út nr. 2, 1087 Budapest, Hungari, do të fitojë kontrollin mbi **COLT CZ HUNGARY ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG (Colt CZ Hungary Zártkörűen Működő Részvénytársaság)**, me seli të regjistruar në rr. Bem József út nr. 1, 6100 Kiskunfélegyháza, Hungari.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

N7 DEFENCE HOLDING ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG është shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rr. Asztalos Sándor út nr. 2, 1087 Budapest, Hungari. Bëhet fjalë për një shoqëri holding hungareze, veprimtaria kryesore e së cilës është veprimtaria e shoqërive holding, përkatësisht administrimi dhe bashkimi i pronësisë mbi asete të ndryshme nga industria e mbrojtjes.

N7 DEFENCE HOLDING ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG ka një person juridik të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht Shoqërinë për Shërbime të Komunikimit ONE MAKEDONIJA TELEKOMUNIKACII SHPKNJP Shkup, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në rr. Crvena Voda nr. 7/3, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, veprimtaria kryesore e së cilës është telekomunikacioni pa tela.

COLT CZ HUNGARY ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG është shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rr. Bem József út nr. 1, 6100 Kiskunfélegyháza, Hungari, veprimtaria kryesore e së cilës është prodhimi i armëve të lehta (armëve të kalibrit të vogël).

COLT CZ HUNGARY ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG nuk ka persona të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu relevant të përkufizohet si tregu i prodhimit dhe furnizimit me armë të lehta (armë të kalibrit të vogël) për përdoruesit ushtarakë, policorë dhe përdoruesit e tjerë nga sektori i sigurisë, në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të jetë objekt i dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimmarrja përfundimtare lidhur me këtë çështje mbetet e rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të paraqesin vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: kzk@kzk.gov.mk, dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

16.11.2026

Shkup